- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Formularin e Çmimit të Ofertes, sipas shtojcës Extra;
- c. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- e. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- f. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë

elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. ✓

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet 2017, 2018 dhe 2019 në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.
- Kopje e vërtetuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019) të paraqitura pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet.
- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara për vitin 2020

2.3 Për kapacitetin teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për transportin e materialeve të ndërtimit:

a). Në funksion të zbatimit të kontratës, kërkohet të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Automjet për transportimin e materialeve të ndërtimit	Cope	1	Pronësi ose me qera

b). Për të dëshmuar këtë, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistrat publike, nëse janë në pronësi, duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.
- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, nëse janë me qera, duhet të paraqiten dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, kontrata noteriale e qerave dhe vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, regjistrimi i mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, policja e sigurimit vjetor.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Blerje materiale ndertimi”

1.Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkuara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

a). Te dhenat teknike te materialeve te ndertimit:

Dokumentat Standarde të Tenderit

Nr	Emertimi	Specifikime teknike
1.	Automat 25A	25A, 220/230V
2.	Automat difirenciale 4P	25A, 4P, Un 220-240V, 30mA, cilesore
3.	Automat difirenciale 4P	63A, 4P, Un 220-240V, 30mA, cilesore
4.	Automat difirenciale 2P	25A, 2P, Un 220-240V, 30mA, cilesore
5.	Aparat guri fleksibel	Cilesore, rpm=6600/min, Φ 230mm/9", W 2200-230, 220-240V-2200W, 50/60 Hz, 10.0 A,
6.	Aparat guri fleksibel I vogel 120	Cilesore, rpm=6600/min, Φ 120mm/9", W 2200-230, 220-240V-2200W, 50/60 Hz, 10.0 A,
7.	Bilbila dritaresh duralumini	Aksesore per dritare duralumini
8.	Binare pishe	Te stazhionuar 5x5cm (4 ml), dru pishe
9.	Bishta druri kazmash	Ahu, cilesore
10.	Bishta druri lopatash	Ahu, cilesore
11.	Bishta druri sopatash	Ahu, cilesore
12.	Bishta furce alum. te gjate	Prej alumini me 3 hapje , per lyerje ne lartesi
13.	Bishta furcesh te gjate	Metalike te gjata per lyerje ne lartesi
14.	Bishta furcesh te thjeshte	Druri ose metali, te zakonshme
15.	Blloqe betoni	Permasat (20x20x40cm)
16.	Boje çimentike	Ngjyra te ndryshme, paketimi 1 kg,
17.	Boje hidroplastike	Boje cilesore. paketimi kova 20 kg,
18.	Boje plastike	Boje cilesore. paketimi kova 10 kg,
19.	Boje vaji	Ngjyra te ndryshme, kuti 1000 gr.
20.	Boljere dushi (horizontal)	Te jete cilasore, drejtimi horizontal,
21.	Brava dyer duralumini	Brava komplet me aksesore per dyer duralumini
22.	Brava sekrete komplet	Brava sekrete komplet me aksesore per dyer druri te cilesise se larte
23.	Brava te thjeshta komplet te gjata	Brava komplet me aksesore per dyer druri te brendshme
24.	Brava te thjeshta komplet te shkurtra	Brava komplet me aksesore per dyer druri te brendshme
25.	Brryla me ngjitje Φ 25	Vespa me ngjitje Φ 25
26.	Brryla lisho me ngjitje Φ 20	Vespa me ngjitje Φ 20
27.	Brryla llamarine xingato	Sherben per shkarkimin e ujrave te catise ,taraces. Φ 100
28.	Brryla me filet me ngjitje Φ 20	Vespa me ngjitje Φ 20
29.	Çekic dore	Cilesore me bisht 2 kg
30.	Çekic dore marangozi	Sherben per punime marangozi dhe heqje gozhdash
31.	Çekic dore prej gome	Sherben per punime shtrim pllakash
32.	Çelsa elektrik i thjeshte	Te thjeshte
33.	Çelsa elektrik shuko	16 A
34.	Çimento 42,5 R	Marka 42,5 R (thase 25 kg)
35.	Dado+ bullona	M 8 x 90 mm me koke te sheshte
36.	Derrase pishe	E stazhionuar 3cm x 400 cm (pishe)
37.	Doreza bravash	Doreza per brava te thjeshta
38.	Doreza dritare duralumini	Aksesore per dritare duralumini
39.	Doreza pune	Material pambuku te veshura me gome te forta, komode.
40.	Dryna te medhej per dyer	Sherbejne per mbylljen e dyerve (kase+dere)
41.	Elektroda saldimi	Per saldime, Φ 2,5
42.	Elektroda togezimi	L= 40x40x4 H=1.5

Dokumentat Standarde të Tenderit

43.	Fishek brave sekrete	Sherbejne per brava sekrete cilesore
44.	Flakon (llampe gazi)	Sherbejne per ngjitje katrama, komplet me aksesore
45.	Fole oxhaku	Sherben per lidhjen e tubit me oxhakun Ø 100
46.	Furce lyerje me boje vaji	Per lyerje me boje vaji 2.5
47.	Furce kendore	Te jene cilesore per lyerje me gelqere te kendeve te ndryshme
48.	Furce per lyerje me gelq.	Te jene cilesore per lyerje me boje hidroplastike
49.	Furce per suvatim	Sherben per lagjen e mureve gjate suvatimit dhe rifinitures
50.	Galixhan depozite 1"	Me shine per depozita uji te medha
51.	Galixhan depozite 3/4"	Me shine per depozita uji te medha
52.	Galixhan depozite Φ 1/2"	Te jete cilasore me shine per depozita uji te medha
53.	Ganxha per ulluk shkarkimi horizontal	Ganxha sherbejne per mbajtjen e ulluqeve te shkarkimit horizontal
54.	Gelqere e shuar (qull)	E stazhionuar (thase 50 kg)
55.	Govata llaqi	Plastike me doreza per mbajtjen e llaqit, 40 lit.
56.	Gozhda betoni	Sherbejne per fiksimin e materialeve ne beton
57.	Gozhda me ngjyre	Cilesore me ngjyre
58.	Gozhda te ndryshme	Te dimensioneve te ndryshme cilesore
59.	Gozhda xhamash	Sherbejne per vendosjen e xhamave ne dritare druri
60.	Flete Guri fresibel hekuri	Per prerje hekuri, Φ 200-230
61.	Hekur katror 12x12	shufra 6 ml 12mm x 12mm
62.	Hekur katror 30x30	shufra 6 ml 30mm x 30mm
63.	Hekur katror 40x30	shufra 6 ml 40mm x 30mm
64.	Hekur katror 40x40	shufra 6 ml 40mm x 40mm
65.	Hekur katror 40x50	shufra 6 ml 40mm x 50mm
66.	Profil U 30x15 me vrima	shufra 6 ml 30mm x 15mm
67.	Pllafonnier LED 24W	Ndricim i bardhe, 24W, 85-265V, 50/60Hz. Ø 300,
68.	Hekur betoni	shufra 12 ml Φ 10
69.	Hinka llamarine xingato	Sherben per shkarkimin e ujrave te catise ,taraces. Ø 100
70.	Hollandez 1"	metalike
71.	Hollandez 1/2	metalike
72.	Hollandez 3/4	metalike
73.	Hollues boje	Paketim 0.5lit
74.	Izolant i madh	Sherben per izolim gjate procesit te instalimeve elektrike
75.	Impiant per vaditje metalik	Cilesore, metalik .
76.	Kabull elektrik AL 4x16	Nentokesor AL 4x16 nentokesore
77.	Kapak prize 3 vend.	Cilesore Plastik
78.	Kapak prize 4 vend.	Cilesore Plastik
79.	Kaprikoda togezimi CU 25	Cilesore CU 25
80.	Kapse kabulli	Cilesore, per kabull gershet 4x16
81.	Kapak morseterie per shtylla 9 ml	Kapak morseterie shtylle

Dokumentat Standarde të Tenderit

82.	Kazma pune	Cilesore me bishte druri
83.	Kapse tubi	Per fiksimin e tubave Ø 20 jashte muri
84.	Kapse tubi	Per fiksimin e tubave Ø 25 jashte muri
85.	Kendore metalike per montim lavolinash	Sherbejne per riparime tavolinash me tre vrima
86.	Kembe tavolinash	sherbejne per montimin ne tavolina
87.	Klema 35	Cu 35 cilesore
88.	Klema 16	Cu 16 cilesore
89.	Koke steke per lyerje me gelqere	Cilesore per steka lyerje me galqere
90.	Koke kacavidash	Cilesore,
91.	Kolle per pllaka	Sherben per shtrim dhe veshje pllakash thase 20 kg,DV 2000
92.	Kompesate	Per riparim dyersh
93.	Kova te zeza per llac	Ngjyre e zeze per mbajtjen e llacit, 8 lit.
94.	Kuader automat 24 vend.	24 vendesh cilesore
95.	Kuti prize brenda murit	3 vendesh cilesore
96.	Kuti prize brenda murit	4 vendesh cilesore
97.	Kuti prize jasht murit	4 vendesh cilesore
98.	Kuti prize jasht murit gewis	3 vendesh cilesore
99.	Kunder-valvol 1"	Sherben per instalime hidraulike metalike
100.	Kunder-valvol dushi	Cilesore per boljere dushi
101.	Kunder-valvol Φ 3/4"	Sherben per instalime hidraulike Φ 3/4"
102.	Laminat per shtrim dysHEMEJE	Cilesore, kategoria AC3 pa fuge permasat 1200 mm x 1191 mm x 8mm
103.	Leve me thember	Sherben per prishje betoni, Φ 22
104.	Llamarine tip tjegulle	Cilesore e lyer, imitim tjegulle
105.	Llampa elektrike	Cilesore 100 W
106.	Llampa LED 10w ndriqim i bardhe	10w ndriqim i bardhe 230V cilesore
107.	Llak transparent	cilesore sherben per lyerje mobiljesh
108.	Litar lini	sherben per instalime hidraulike
109.	Lopata pune	Cilesore me bishte druri
110.	Lopata pune kendore	Cilesore me bishte druri
111.	Lopata pastrimi mbeturinash	Alumini,te medha, me bisht druri
112.	Manikota lisho me ngjitje Φ 20	plastike me ngjitje
113.	Manikota lisho me ngjitje Φ 25	plastike me ngjitje
114.	Manikota me filete Φ 20	plastike me ngjitje
115.	Manikota metalike 1/2"	metal
116.	Manikota metalike 3/4"	metal
117.	Mastar alumini 2ml	Prej alumini per drejtim muri dhe suvaje gjat. 2 ml
118.	Mentesha dyersh hekuri	Sherbejne per dyer metalike Φ 12
119.	Mentesha dyersh kunje	Sherbejne per dyer druri Φ 16
120.	Mentesha per dryna	Sherbejne per mbylljen e dyerve (kase+dere)
121.	Mentesha raftesh	Sherbejne per rafte te ndryshme
122.	Mistri muratori	Cilesore te zakonshme
123.	Nipla metalike 1/2"	metalike

Dokumentat Standarde të Tenderit

124.	Nipla metalike 3/4"	metalike
125.	Percina metalike	Sherben per precinosje te ndryshme,me fund te hapur alumin-celik, 3.2x12.7
126.	Percina metalike	Sherben per precinosje te ndryshme,me fund te hapur alumin-celik, 3.2x10
127.	Percina metalike	Sherben per precinosje te ndryshme ,me fund te hapur alumin-celik,4x12.7
128.	Percina metalike	Sherben per precinosje te ndryshme ,me fund te hapur alumin-celik,4x16
129.	Perdaf suvatimi	Sherben per suvatime, , suport plastik, 14x22cm
130.	Pigment boje	Ngjyra te ndryshme, kuti 500 gr
131.	Pllaka majolike	Sherben per shtrim
132.	Pllaka majolike	Sherben per veshje
133.	Pllake fibre	Sherben per riparim dyer dhe tavane
134.	Portollampa	cilesore te thjeshta
135.	Priza elektrike e thjeshte	Cilesore 16 A
136.	Priza elektrike shuko	Cilesore 16 A ngjyre e bardhe
137.	Priza elektrike bivalente	Cilesore 16 A ngjyre e bardhe
138.	Llaq i perzier	Llaq i perzier per suvatime (thase 30 kg)
139.	Rere suvatimi	Rere per suvatime per fino
140.	Rrjete teli	Cilesore per vendosje ne dritaret e guzhinave te objekteve
141.	Rubineta uji	Cilesore, Φ 1/2".
142.	Rula per lyerje	Sherbejne per lyerje te sperfaqeve me boje hidroplastike cilesore
143.	Saraçineske 3/4"	Sherben per instalime hidraulike 3/4" metalike
144.	Saraçineske + hollandez	Saracineske+hollandeze per instalime hidraulike Φ 1/2"
145.	Saraçineske + hollandez 3/4"	Saracineske+hollandeze per instalime hidraulike 3/4" metalike
146.	Saraçineske Φ 3/4"	Sherben per instalime hidraulike Φ 3/4"
147.	Sharre dore	Cilesore per prerje materialesh prej druri
148.	Shirit sinjalizim punimesh	sherben per sinjalizime punimesh
149.	Shkume dyersh e madhe	Sherben per montim,shtrengim dyer,dritare
150.	Shkume dyersh e vogel	Sherben per montim,shtrengim dyer,dritare
151.	Shpatull per stukime	Sherben per stukime para lyerjes me gelqere
152.	Shula dere	Aksesore per dyer
153.	Sifon lavamani	Plastik cilesore
154.	Sifon wc	Plastik cilesore
155.	Silikon transparent	Sherben per montim,shtrengim dyer,dritare, pajisje te ndryshme
156.	Site teli	site teli e imet per sitjen e lengut te gelqeres
157.	Sopata drush	Cilesore me bishte druri
158.	Spango	Cilesore
159.	Spina elektrike te thjeshta	Cilesore 16 A
160.	Sqepar	Cilesore me bishte druri
161.	Stuko per pllaka	Sherben per stukim pllakash ngjyra, te ndryshme

Dokumentat Standarde të Tenderit

162.	Suport 3 vend	3 vendesh cilesore
163.	Suport 4 vend	4 vendesh cilesore
164.	Shkalle alumini me kater palosje	cilesore me 4 palosje, lartesia 5 ml.
165.	Tambure kabulli elek.	3x2.5 x 50 ml, H05VV-F3G1.5,1000W,3500W/16A/230V,
166.	Tape 1/2	Vespa me ngjitje
167.	Tel bari	Sherben per lidhje te zgarave te hekurit
168.	Tel elektrik Φ 1,5mm	1x1.5mm ² cilesore
169.	Tel elektrik Φ 2,5mm	1x2.5mm ² cilesore
170.	Tel elektrik Φ 4mm	1x4mm ² cilesore
171.	Tel elektrik Φ 6mm	1x6mm ² cilesore
172.	Tel elektrik petashuk	2x1.5mm ² cilesore
173.	Tel xinguar	I zinguar
174.	Teflon hidraulik	sherben per intalime hidraulike
175.	Tapa fallco	Plastike per priza dhe çesesa elektrik
176.	Tije me ngjitje Φ 25	plastik me gomine presioni
177.	Tije lisho Φ 20	plastik me gomine presioni
178.	Tjegulla importi kulmore	Sherbejne per kulmet ne çati me tjegulla
179.	Tjegulla importi lug	Tjegulla ne forme lugu
180.	Trapon per perzierje boje	Sherben per perzierjen e bojrave para lyerjes , me dy doreza
181.	Trapon dore	Sherben per punime marangozi
182.	Tub elektrik i rende 20 mm	I rende 20mm
183.	Tub elektrik i rende 25 mm	I rende 25mm
184.	Tub shkarkimi llamarine xingato	Sherben per shkarkimin e ujrave te catise ,taraces.Ø 100
185.	Tub vespo Φ 1/2"	Sherben per instalime hidraulike Φ 1/2"
186.	Tulla oxhaku	Sherbejne per ngritje oxhaku mbi cati dhe tarace (20x20x25cm)
187.	Tutkall plastik (vinovil)	Sherben per ngjitjen e meterialeve prej druri(paketimi 1 kg)
188.	Upa Φ 6,8,10,12	Cilesore Φ 6,8,10,12
189.	Vida druri te ndryshme 5 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore, 5x40
190.	Vida druri te ndryshme 3.5 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore, 3.5x30
191.	Vida druri te ndryshme 3.5 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore, 3.5x40
192.	Vida druri te ndryshme 6 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore ,6x70
193.	Vida druri te ndryshme 6.3 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore ,6.3x50
194.	Vida druri te ndryshme 6 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore, 4x25
195.	Vida druri te ndryshme 8 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore, 8x70,8x80,8x90
196.	Vida druri te ndryshme 4 cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore, 6x90
197.	Vida punto 1.8cm,2.5cm,3cm,4cm,5cm	Sherbejne per riparimin e pajisjeve shkollore . 1.8cm,2.5cm,3cm,4cm,5cm
198.	Vida dushi	Cilesore per montim boljeresh
199.	Vida lavamani	Sherbejne per montimin e lavamanave

Dokumentat Standarde të Tenderit

200.	Xhela oxhaku	Drejtues te eres mbi oxhak (llamarine)
201.	Zhavorr per beton	I fraksionuar per beton M-200

3.Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Materialet do te merren ne dorezim sipas afatit te percaktuar ne DST
- Të gjitha materialet duhet të jenë prodhime brenda standartit të CE
- Materialet do te dorezohen brenda orarit zyrtar te punes dhe jo ne dite pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do te behet nga kontraktuesi me automjetet e tij nga pika e furnizimit deri ne destinacion (magazina e institucionit).
- Materialet objekt prokurimi duhet te jene konform standarteve teknike te percaktuara ne ligjin Nr.9290 date 07.10.2004 “Per produktet e ndertimit”, si dhe te plotesojne te gjitha kerkesat per vleresimin e konformitetit
- Ne rast se malli objekt prokurimi, nuk ploteson kerkesat dhe standartet teknike, nuk do te merret ne dorezim.
- Per detaje me te veçanta do te percaktohen ne kontraten objekt prokurimi me operatorin ekonomik (OE) te shpallur fitues.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca Extra

FORMULARI I ÇMIMIT TE OFERTES “Blerje materiale per lysterjen dhe mirermbajtjen e objekteve arsimore”

- Formulari bashkangjitur dokumentave standarte te tenderit

Shenim:

- Ky formular duhet t'i bashkangjitet shtojces Nr.1

- Çmimet duhet të jenë të shprehura në lekë

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]
SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT
“Blerje materiale ndertimi”

a).Sasia e mallit që kërkohet:

- Eshtë e specifikuar në Formularin e Çmimit të Ofertes

b).Afatet e lëvrimit:

- Brenda 7 (shtatë) diteve nga nënshkrimi i kontratës

c). Afatet e lëvrimit:

- Afati i furnizimit të mallit (material ndertimi) do të jete brenda 7 (shtate) diteve nga data e nënshkrimit të kontrates (sipas kërkeses së AK)

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e

Dokumentat Standarde të Tenderit

dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)
Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Dokumentat Standarde të Tenderit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe

Dokumentat Standarde të Tenderit

referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e

Mallrave sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse

Shqiptare.

- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilesinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës

- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
